



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”
ofruan nga
Universiteti European i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Partizan MALKAJ

Dr. Altina XHAFFERI

Nëntor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Imazherisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 648, datë 11.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr.2484/1, datë 21.08.2023
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 128, datë 15.07.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim BA Nr. 15, datë 25.02.2022
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 8 PAE / 0 PAK; 2023-2024 9 PAE / 3 PAK; 2024-2025 8 PAE / 3 PAK;
18	Numri i studentëve:	Va: 2022-2023 28 studentë; Va: 2023-2024 45 studentë; Va: 2024-2025 60 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Europian i Tiranës (UET) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, me statusin Shkollë e Lartë Universitare Jo publike. Përgjatë viteve ky IAL ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij. Me VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 ndryshon statusi nga Shkollë e Lartë Universitare Jo publike në Universitet, me emërtimin “Universiteti Europian i Tiranës”. UET është e organizuar në pesë fakultete.

Institucioni ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, dhe riakreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL, por edhe nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 46, datë 05.07.2019, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.

Struktura akademike e “Universitetit Europian të Tiranës”, aktualisht përbëhet nga pesë njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare;
2. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale;
3. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit;
4. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës;
5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

Programi i studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” është hapur me Urdhër të MASR Nr. 648, datë 11.10.2018 me formë studimi me kohë të plotë, 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike. Programi ofrohet nga Departamenti Imazherisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJ konstaton që programi studimi Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” ka rezultate të prekshme në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke u dhënë atyre aftësi për të konkretizuar njohuri teknike imazherike në përgjithësi, aftësi për të veçvepruar në kuadrin e organizimit e kryerjes së punëve zbatuese në ambientet spitalore, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionale, aftësi për të kërkuar zgjidhje duke u konsultuar me përvojën e kolegëve dhe literaturën profesionale, aftësi në menaxhimin e problematikave të ndryshme, njohjen e standardeve dhe metodologjive bashkëkohore. Në të gjitha takimet, por veçanërisht në takimin me studentët, GVJ mësoi që transmetimi i dijeve në kuadrin e këtij programi studimi realizohet me synime të qarta që të diplomuarit e tij të jenë jo vetëm të kërkuar në tregun e punës vendas e të huaj por edhe të realizojnë ambicie të guximshme për të vazhduar studimet e thelluara në ciklet e studimeve Doktoratë. Në përfundim të këtij aktiviteti, GVJ konstatoi që programi studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” zhvillohet si një program studimi, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Vetë plani mësimor dhe programet e lëndëve janë profilizuar tashmë në ofertën e dijeve që i çon natyrshëm studentët si tek vazhdimi i cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe tek tregu i punës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UET, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Altina Xhaferi dhe Prof. Partizan Malkaj. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknike i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Grupi u njoh dhe studioi dosjen e vetëvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, plotësimin e informacioneve, konkretizimin e paraqitjeve dhe saktësimin e vlerësimeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me agjendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me datën 29 Prill 2025. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Shefin e Departamentit të PS Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”. Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimin të standardeve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënien, mësimnxënien dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.

Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetëvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).




SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 15, datë 25.02.2022, "Për akreditimin e parë të programit të studimit **Master i Shkencave në "Imazheri dhe Radioterapi"**, të Universitetit European të Tiranës, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit, me qëllim që njohuritë e ofruara në të, të jenë në përputhje me nivelin e programeve të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave.
2. Institucioni, të marrë masat e nevojshme që dy specialitete të ndryshme, si ai i imazherisë e radioterapisë, të mos ofrohen në strukturën e një programi të vetëm.
3. Institucioni, të përfshijë në programin e studimit, të gjitha veprimtaritë formuese, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
4. Institucioni, të përditësojë syllabuset e programit të studimit, duke përfshirë në to tematika e njohuri që janë në përputhje me nivelin e programeve të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave.
5. Institucioni, të sigurojë e përmirësojë infrastrukturën e nevojshme laboratorike, për realizimin me sukses të këtij programi studimi.
6. Institucioni, të rrisë fondin e literaturës së bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe të huaj, në fushën e imazherisë e radioterapisë.
7. Institucioni, të sigurojë informacionin e nevojshëm për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë program studimi, mbi infrastrukturën laboratorike dhe teknologjitë e përdorura për realizimin e praktikave mësimore të radioterapisë.
8. Institucioni, të mbështesë kualifikimin e vazhdueshëm dhe aktivitetin kërkimor-shkencor të personelit akademik të këtij programi studimi, duke i nxitur ata të publikojnë në revista ndërkombëtare të indeksuara dhe me faktor impakti

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Rishikim i kurrikulës nga ekspertë të fushës, në funksion të përputhshmërisë me rezultatet e të nxëniet të programit të studimit "Imazheri dhe Radioterapi si cikël i dytë i studimeve, referuar nivelit të njohurive, aftësive dhe kompetencave që përcaktohen në Kurrikulën Kombëtare të Kualifikimeve dhe direktivave ndërkombëtare në fushën e studimit. Reflektimi i ndryshimeve në masën deri 20% të kurrikulës. *Përmbyshur plotësisht*



2. Ankimuar me shkresë UET Nr. 40/1, dt. 03.06.2022. Institucioni parashtron ngjashmërinë e programit që ai ofron me simotrat e tij në Universitetet të tjera të njohura ndërkombëtare. *Nuk është përmbushur.*

3. Vendim Departamenti për adresimin e rekomandimit (Vendim Nr.50. Prot, datë 11.06.2021) Vendim Dekanati për adresimin e rekomandimit (Vendim Nr.52. Prot, datë 15.06.2021) Vendim Senati për miratimin e shtimit të lëndëve me zgjedhje (Vendim Nr.15. Prot, datë 22.07.2021). Institucioni ka marrë masat për përmirësimin e kurrikulës dhe veprimtarive formuese Brenda tij në bazë të legjislacioni në fuqi. *Përmbushur plotësisht*

4. Rishikimi i syllabuseve të programit të studimit në masën mbi 80%, me fokus në: a) përputhshmërinë e rezultateve të të nxënësve me përmbajtjen dhe rezultatet b) e parashikuara të programit; përditësimin e literaturës sipas standardeve të përcaktuara në aktet rregullatore të UET. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga IAL vihet re përmirësimi i elementëve të syllabuseve në përputhje me ciklin e programit të studimit dhe njohurive që ai duhet të ofrojë. *Përmbushur plotësisht*

5. Evidentohet krijimi i kushteve të nevojshme laboratorike dhe sigurimi i infrastrukturës më të avancuar laboratorike, në funksion të programit të studimit. *Përmbushur plotësisht*

6. Planifikimi dhe realizimi i orëve laboratorike dhe praktike në institucione të ndryshme spitalore të vendit, me objekt njohjen dhe aftësimin me apartaturat për mbrojtjen e individit nga rrezatimet e ndryshme. Sigurimi fizik dhe vënia në dispozicion të studentëve pranë Librarisë së UET të botimeve në gjuhën shqipe, të fushës së imazherisë dhe radioterapisë, që i përmbahen standardeve të UET për literaturën. Vendosija në dispozicion pranë Bibliotekës ose elektronikisht në LMS, e teksteve në gjuhë të huaja që i përmbahen standardeve të UET për literaturën, në kuadër të mbarëvajtjes së programit të studimit dhe përditësimit me zhvillimet më të fundit në sferën e botimeve akademike në fushën e Imazherisë dhe Radioterapisë. Stafi pedagogjik dhe studentët referojnë përshtatjen e leksioneve në gjuhën shqipe nga ana e pedagogëve të lëndëve. Sigurimi i materialeve mësimore në formën e leksioneve të përgatitura bazuar në literaturën e përzgjedhur që i përmbahen standardeve të UET dhe vënia në dispozicion të studentëve nga stafi akademik i programit. *Përmbushur plotësisht*

7. Ankimuar me shkresë UET Nr. 40/1, dt. 03.06.2022. Institucioni ka iniciativë për angazhimin më të lartë të stafit akademik dhe mbikëqyrës në fushën e radioterapisë. Kabinetet e radioterapisë janë të limituara në shqipëri dhe realizimi i këtyre praktikave has në vështirësi. *Përmbushur kryesisht.*

8. Institucioni ka nisma për mbështetjen e stafit pedagogjik me dhënien e bursave dhe shpërblimeve financiare për edukimin në vazhdim të stafit pedagogjik. Stafi akademik stimulohet të botojë në revistën e UET, si dhe përkrahët në aktivitetin e tyre shkencor në fitimin e gradave dhe titujve akademikë. *Përmbushur plotësisht.*

Më datë 29.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.14/34 Prot., datë 27.10.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 07.11.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.186/4 Prot., datë 05.11.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin:

GVJ, pasi u njoh me komentet e IAL-së, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

Komente mbi standartin I.2

Në programin e Imazheri dhe Radioterapi si staf i ngushë profesional efektiv është një pedagog me Titullin Ass Prof dhe 2 asistent lektore aktualisht me MSC dhe në proces për marrjen e gradës shkencore Dr. Pavarësisht eksperiencës së pamohueshme profesionale të tyre në ciklin e 2 të studimeve pedagogët që duhet të japin mësim duhet të jenë të paktën me gradën shkencore Dr.

Raporti nuk ndryshon.

Komente mbi standartin II.1

Qëndron vlerësimi i GVJ se emërtimi jo i saktë i programit mund të përbëjë konfuzion në studentin aplikant. Siç edhe vetë institucioni ka reflektuar në komentet e dhëna, edhe në shembujt specifikë të ofruar nga IAL, emërtimi i programit me terminologjinë “Shkencat” apo “teknikat” e Imazherisë dhe radioterapisë i përket më mirë programit që ofron.

Raporti nuk ndryshon.


Komente mbi standartin II.4

Përsa kohë IAL ofron program studimi në gjuhën shqipe literatura e detyrueshme duhet të jetë në gjuhën shqipe, qoftë kjo edhe e përshtatur nga literatura e huaj. Literatura për lexim në gjuhë të huaj mund të konsiderohet në rubrikën e literaturës së sugjeruar (qoftë kjo në anglisht, gjermanisht apo frengjisht etj), kështu kjo gjë nuk penalizon asnjë student i cili njih një gjuhë të BE (përvec anglishtes).

Raporti nuk ndryshon.

Komenti mbi standartin IV.1:

Kriteri 1&3: Qëndron vlerësimi i GVJ i shprehur në raport përsa i përket kualifikimit të stafit akademik. Në lidhje me kontratat: nga zyra përgjegjëse na u dha kontratë që një pedagog i brendshëm figuronte i punësuar me kohë të plotë pranë një institucioni publik (Duhet verifikuar nëse kjo është në përputhje me ligjin mbi dy punësimin) dhe nuk na u dha kontratë punësimi në institucionin UET.



Kriteri 2: Qëndron vlerësimi i GVJ shprehur në raport në lidhje me ngarkesën mësimore. Nuk përlijet nga ana shkencore fakti që një numër i konsiderueshëm lëndësh në nivel Masteri Shkencor të jepen nga një personel akademik. Është e vërtetë që mund të mos parashikohet në aktet ligjore përkatëse, por kjo nuk ka të bëjë me ngarkesën mësimore që një personel akademik duhet të realizojë: Lidhet me nivelin shkencor dhe profesional. Kualifikimi shkencor në nivele të tilla konsiderohet për specialitete shume të ngushta.


Raporti nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave Imazheri dhe Radioterapi

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Europian i Tiranës (UET) synon arritjen e standardeve më të larta akademike, mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor, përgatitjen e specialistëve të lartë në fushën e mjekësisë. Institucioni ofron program studimi që është në përputhje me interesat kombëtare dhe institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë. <i>(statuti i UET)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që programi studimi i ofruar nga IAL mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare. <i>(statuti i UET)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programet e studimit të ofruara nga UET synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UET. Këto programe tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare si dhe synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>(statuti i UET)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në	Programet e studimit të ofruara nga UET synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me strategjinë kombëtare dhe objektivat e UET. Këto programe tentojnë të ruajnë vlerat dhe interesat kombëtare si dhe synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre.



dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<i>(statuti i UET)</i>		
Konkluzione	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UET ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruaje vlerat akademike kulturore kombëtare;</i> - <i>Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialistë të lartë në fushën e mjekësisë;.</i> 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>UET ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë ç'ka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukture që disponon. UET ka eksperiencë disa vjeçare në programin e studimit Imazheri dhe Radioterapi. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Imazherisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Ky i fundit ka një staf akademik me formim profesional të kualifikuar dhe me grada shkencore në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë.</p> <p>Ky Fakultet për vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 29 pedagogë, nga të cilët 22 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 2 kanë titullin "Profesor", 5 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 4 kanë gradën Doktor Shkencash dhe 9 Pedagogë janë në proces për përfitim të Gradës Doktor dhe 2 Asistent Lektorë me Msc; dhe 7 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka gradën Doktor shkencash, 1 është në proces doktorature dhe 5 pedagogë me Msc. Ndërsa Departamenti i Imazherisë ka 7 PAE ku 1 është Prof.Dr., 2 janë Prof.As, dhe 4 janë në proces doktorature, kurse 4 PAK, ku 1 është Dr. Dhe 3 me MSc.</p>

	<p><i>Për sa më sipër, GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Departamenti i Imazherisë, ka një numër të reduktuar të profesionistëve që mbulojnë lëndët dhe modulet specifike të avancuara që duhet të ofrojë ky program. GVJ theksoi gjatë takimit mbingarkesën akademike të pedagogëve efektivë që mbulonin pjesën më të madhe të ngarkesës në këtë program.</i></p> <p><i>(Të dhënat tabelore për personelin akademi në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse)</i> <i>(Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të Fakultetit dhe departamentit që e ofron programin. Programi i studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore. Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar.</p> <p><i>(Statuti i UET)</i> <i>(Rregullore e UET)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Imazherisë, i cili duhet të përmirësojë kapacitetet akademike dhe logjistike për realizimin me sukses të programit mësimor. Fusha së cilës i përket Programi i Studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, sipas klasifikimit/kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe europiane. Departamenti i Imazherisë i cili është përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi ofron dhe program studimi të ciklit të parë.</p> <p><i>Plani strategjik për zhvillimin e Programit të studimit Master I Shkencave në Imazheri dhe Radioterapi</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>IAL nuk ofron Master profesional</p>





<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se Universiteti European i Tiranës ka ngritur marrevëshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme kryesisht brenda vendit. Institucioni referon për strategji të mëtjshme bashkëpunimi me institucionet shëndetësore. Aktualisht në këtë program studimi janë diplomuar një brez studentësh por UET krijon eksperiencën e duhur dhe bashkëpunimet e nevojshme për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për studentët e diplomuar.</p> <p><i>(Vizita në IAL)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UET ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruaje vlerat akademike kulturore kombëtare; - Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialist të lartë në fushën e mjekësisë; <p>UET ka nevojë për përmirësimin e stafit akademik dhe aq më tepër të ngarkesës së marrë përsipër prej tyre e cila mund të kompromentojë procesin cilësinë e mësimdhënies</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e</p>	<p>UET koordinon veprimtarinë e tij dhe mbarëvajtjen e programit nëpërmjet koordinimit brenda institucionit. Pësha e mbarëvajtjes së Programit të studimit mbulohet nga Departamenti i Imazherisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Departamenti dhe njësia bazë siguron mbarëvajtjen e programit nëpërmjet përgjegjëseve të grup lëndëve</p>




<p>personelit, marrjes së përgjegjëse përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><i>Plani strategjik për zhvillimin e Programit të studimit Master I Shkencave në Imazheri dhe Radioterapi</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e elementëve të procesit mësimor Universiteti ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet institucioneve simotra që ofrojnë të njëjtin program studimi si dhe me institucione shëndetësore ku parashikohet bashkëpunim në drejtim të realizimit të praktikave profesionale. Gjithashtu UET siguron bashkëpunimin dhe me aktorë të tjerë të tregut të punës.</p> <p><i>Parimet e ndërtimit të programit</i> <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni merr masat për nënshkrimin e marrëveshjeve të shumta bashkëpunimi me institucione, organizata, kompani, shkolla, klinika, spitale kryesisht për realizimin e praktikave profesionale. Ky proces koordinohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Gjithashtu UET ka caktuar pedagog përgjegjës mbikëqyrës të praktikave profesionale.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë harton raporte për analizimin e arritjeve dhe përcaktohen objektivat e viteve akademike në vijim. Studentëve ju ofrohet mundësia që nëpërmjet një pyetësori të jepet informacioni mbi efektivitetin e praktikave profesionale dhe nëse paraqitet e nevojshme përmirësimi i ndonjë hallke të tyre.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave të programit</i></p>




Konkluzione	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p> <p><i>-Institucioni UET siguron marrëveshje bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas e të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit</i></p> <p><i>- Institucioni bën analiza vjetore në lidhje me realizimin e programeve të bashkëpunimit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>PS Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, është organizuar në module të cilat, mbështetur nga udhëzimet e MAS, janë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit europian ECTS.</p> <p>Programi ka ngarkesë mësimore prej 120 kredite me përpyekjen për tu balancuar me ndarje të barabartë mes dy viteve akademikë. Programi është i shtrirë në 2 vite akademikë dhe në 4 semestra. Lëndët kanë secila nga 6 kredite ECTS, ndërkohë që praktika profesionale është e organizuar në 12 kredite. Përgatitja e diplomës është vlerësuar me 18 kredite.</p> <p><i>Kurrikula e programit të studimit</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh,	Programi i studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, synon përgatitjen e studentëve me nocione të avancuara profesionale dhe akademike. Lëndët janë multidisiplinare dhe përgatisin studentët për tregun e punës. Lëndët




<p>jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>janë specifike në lidhje me teknikat e avancuara radiologjike, mjekësinë nukleare dhe radioterapinë. Synimi i programit të studimit është të përgatisë profesionalisht studentët për punësim në kabinete të ndryshme radiologjike. Programi gjithashtu synon dhënien e informacioneve dhe për përgatitjen shkencore të studentëve</p> <p><i>Kurrikula e programit të studimit</i> <i>Programi I studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar kreditet për realizimin e praktikave, si ato profesionale ashtu edhe ato lëndore. Programi i studimit ka balancuar shumë mirë shpërndarjen e krediteve të praktikave profesionale me kreditet e lëndëve teorike. Studentët realizojnë një provim përfundimtar përmblendës të praktikave në praninë e një komisioni me tre anëtarë. Studentët realizojnë praktikat profesionale në spitale universitare ai QSUT, “Shefqet Ndroqi” dhe spitale të tjera rajonale sipas marrëveshjeve.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Kurrikula e programit</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>




<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UET është institucion jo publik dhe nuk ka status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. Forma e studimit është me kohë të plotë. UET mbështetet në kriteret e përgjithshme sipas udhëzimeve të MAS. UET nuk ka element të veçantë apo përjashtues në lidhje me pranimin e studentëve në këtë program. UET ndjek hallkat e nevojshme për kodifikimin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit ka ngjashmëri në përmbajtjen e tij me programet e tjera të studimit të ngjashme në rreth 70% të tij. Ketu merret ne konsiderate nje program i ngjashem qe ofrohet nga Universiteti i Mjekesise, Fakulteti i Shkencave mjekesore Teknike. Ky program I UET ka zgjeruar emërtesën e tij përveçse në Imazheri edhe në Radioterapi <i>GVJ sugjeron që Emërtimi i këtij programi mund të krijojë konfuzitet në emërtesën e tij. GVJ ka sygjerruar aktorët përgjegjës në këtë institucion të rregullimit të emërtesës me termin shtesë Teknik Imazherie dhe Radioterapi.</i> <i>GVJ evidentoi që ky emërtim ishte I tillë në variantin anglisht të</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, ka ndërmarrë masat e nevojshme për kodifikimin sipas standardeve kombëtare të kodifikimit të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Ky kodifikim është në përputhje me nomenklaturën kombëtare të arsimit të lartë</p>




tejkryhetkodifikimiilëndëvetëprogramit.	<i>Kurrikula e programit të studimit</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” nuk është i përbashkët me asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë.			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i> <i>- Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i> <i>-Institucioni duhet të evitohet keqkuptimet në titullin e emërimit të diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2				
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. UET i ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional. Institucioni përpaket të angazhojë staf akademik me grada dhe tituj akademik për të siguruar rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Për të siguruar rritjen e cilësisë së mësimdhënies institucioni angazhon stafin akademik, ndihmës akademik por edhe studentët për marrjen e masave të nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen në procesin mësimor teorik dhe praktik. Stafi akademik PAE dhe PAK i departamentit të Imazherisë, për 3 vitet e fundit akademike është si më poshtë:			
		2022-2023	2023-2024	2024-2025

	Kualifikimi i stafit akademik të DI	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	1	-	-	-	1	-
	Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	-
	Dr/Phd	2	1	1	-	-	1
	Dr. proc	-	-	2	1	4	-
	Msc.	3	2	2	3	-	3
	Gjithsej	7	3	7	4	7	4
	<p><i>Tabelat 2.1, 2.2, 2.3 aneks tabelat përmbledhëse Raporti analitik vjetor</i></p>						
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Njësia bazë angazhon personel ndihmës akademik për ndjekjen e praktikave profesionale. Gjithashtu grupet studentore që realizojnë praktika në institucionet e ndryshme shëndetësore janë nën udhëheqjen e një tutori që ndjek praktikën studentore në institucionin ku zhvillohet praktika.</p> <p><i>Rregullorja e praktikave profesionale</i></p>						
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Departamenti i Imazherisë mbështetur edhe në rregulloren e UET ka caktuar një koordinator për programin e studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”. Në këtë rregullore përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinorit të programit. Koordinatori ka për detyrë të vëzhgojë mbarëvajtjen e programit të studimit, raporton te drejtuesi i njësisë dhe dokumenton informacionet që lidhen me këtë program</p> <p><i>Rregullore e UET</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i></p>						
Konkluzione	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p>						

	<p>- Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike,</p> <p>-Institucioni angazhohet me caktimin e koordinatorit të programit si dhe tutorë apo përgjegjës të ndjekjeve të praktikave profesionale</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Imazherisë dhe FSHMT zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit master i shkencave në Imazheri dhe Radioterapi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Informacionet janë të aksesueshme nga çdo anëtar i personelit akademik</p> <p><i>(Plani mësimor),</i> <i>(Rregullorja e programit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor është një tabelë e detajuar me të gjithë elementët e ngarkesës mësimore që përfshijnë leksionet, seminarët, laboratorët, ushtrimet dhe praktikat klinike.</p> <p>Detyrimet akademike që duhet të përmbushë secili student që të klasifikohet në provimin përfundimtar të modulit/lëndës dhe mënyra e pikëzimit në varësi të ngarkesës është përcaktuar me vendim senati dhe përshkruhet në syllabusin e çdo moduli.</p> <p>Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë:</p> <p>Për lëndët e Tipologjisë I <i>Detyra praktike/laborator: 2 (një) x 30% = (60%)</i> <i>Provimi përfundimtar (40%)</i></p> <p>Për lëndët e Tipologjisë II <i>Niveli i diskutimit në seminare (10%)</i></p>

	<p><i>Detyrë kursi/Laborator(20%)</i> <i>Provim i ndërmjetëm (30%)</i> <i>Provimi përfundimtar (40%)</i></p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e Studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin.</p> <p>Në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve të rinj, UET rekruton kandidatët sipas meritokracisë bazuar nga kërkesa e departamentit për numrin e studentëve që mund të rekrutohen në Departamentin e Imazherisë.</p> <p><i>(Vendim senati per kriteret e pranimit të studentëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, kanë të përfshirë të gjithë elementët informues lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxëniet të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si dhe Departamenti i Imazherisë, ka ndërmarrë hapat e nevojshme për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe merr masa që në fillim të vitit akademik të miratojnë ndryshimet eventuale.</p> <p><i>(Raporti analitik vjetor)</i> <i>(Programi i studimit Master i Shkencave në Imazheri dhe Radioterapi)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon qe:</i></p>

	- Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimet e moduleve/lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale përpiqen të mundësojnë thellimin e njohurive, aftësim për punë të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit akademik si dhe lëndë të thellimit të njohurive profesionale. <i>(Programi i studimit Master i Shkencave në "Imazheri dhe Radioterapi")</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përfitimit të njohurive akademike, studenti zhvillon në mënyrë të vazhdueshme lëndë të formimit të thelluar profesional duke përfshirë këtu elementët e studimit që nga onkologjia, radioterapia, mjekësia nukleare, urgjencat, neuroradiologjia etj. Të gjitha këto njohuri i japin studentit aftësinë e nevojshme profesionale për ofrimin e shërbimit të tij në institucionet e ndryshme shëndetësore si dhe në kabinetet e radiologjisë në çdo qendër shëndetësore që i zotëron ato. Po ashtu studenti merr informacione të mjaftueshme edhe në drejtim të formimit akademik të tij. Nga sa më sipër rezulton se lëndët, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe thellimit të njohurive profesionale dhe akademike. <i>(Programi i studimit); (Syllabuset e lëndëve)</i>

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori - praktikë është në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave.</p> <p>Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>(Programi i studimit)</i> <i>(Syllabuset e lendeve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse.</p> <p>Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me institucione që ofrojnë shërbime imazherike, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p> <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”,</i> <i>Marreveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Literatura në gjuhën shqipe të këtij programi ka problemet e veta në mungesën e teksteve në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë të huaj.</i></p> <p><i>Syllabuset e lendeve</i> <i>Lista e literaturës në biblioteke</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” ka premisa për tu ofruar studentëve njohuri dhe</p>

<p>garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>kompetenca të avancuara. Në bazë të rekomandimeve të BA të ASCAL, janë dhënë sygjerrime për përmirësimin e përmbajtjes së syllabuseve dhe shihet përmirësim i ndjeshëm i tyre me qëllim rritjen e nivelit të njohurive të studentëve që ndjekin këtë program.</p> <p>Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p>Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>		
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” ka pësuar ndryshim të përmbajtjes gjë e cila e bën më të lehtë përfitim të njohurive të avancuara për përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>(Programi i studimit Master i Shkencave; Syllabuset e lëndëve)</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës;</i> - <i>programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh Europiane prej 120 ECTS. Çdo vit akademik ka 60 kredite ECTS;</i> <p><i>GVJ vlerëson se ky program studimi me lëndët në përbërje të tij, mënyra e zhvillimit të programit dhe format e kontrollit të njohurive synon drejt përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara;</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe punësim në tregun e punës. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Departamenti i Imazherisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.</p> <p><i>(Programi i studimit MSc)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni është përpjekur vazhdimisht të përfshijë aktorë të ndryshëm në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe takimeve në Instiucion, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike mban kontakte me Urdhrin e Infermierit, FSHMT në UMT si dhe disa shoqata europiane me qëllim përditësimin e syllabuseve të disa moduleve si dhe për integrimin e të rejave të fundit në fushën e radiologjisë në përgjithësi.</p>




institucione publike e private.	<i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit, Raporti vjetor institucional)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që: - Institucioni i Arsimit të Lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Misioni i Departamentit të Imazherisë, është t'u japë studentëve edukim cilësor duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor por dhe te njohuritë praktike profesionale duke vënë theksin në specializimin e tyre të mëtejshëm. Objektivat e këtij program studimi mbështesin objektivat madhorë të Institucionit të Arsimit të lartë UET. <i>Plani Strategjik për zhvillimin e programit</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Imazherisë si pjesë e FSHMT bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik të përfshirë në këtë program. <i>Rregullore e Departamentit</i> <i>Rregullore e FSHMT</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit përfshin studentët e interesuar në studime kërkimore, studime shkencore apo projekte të ndryshme të departamentit. <i>Rregullore e FSHMT</i>

Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni i UET dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. <i>Rregullore e FSHMT</i> <i>Statusi UET</i>		
Konkluzione	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që: - Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit - Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UET mbështet projektet kërkimore shkencore nëpërmjet planit kërkimor shkencor që miratohet paraprakisht nga Senati akademik. Në programin mësimor përfshihen lëndë që japin vazat e kërkimit shkencor (Metodologjia e kërkimit, Menaxhim projektsh dhe vlerësim) si dhe siguron mbështetjen e studentëve në përgatitjen e provimit përmbyllës. Departamenti i Imazherisë në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka me institucionet e tjera studimore universitare përfshin edhe studentët dhe stafin akademik në avancimin e tyre pedagogjik. <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe	Bazuar dhe në Strategjinë e kërkimit shkencor 2021-2025, Departamenti i Imazherisë, angazhohet në zbatimin e planit vjetor të kërkimit shkencor. Për këtë qëllim departamenti angazhon personel akademik dhe studentët. <i>Strategjia e kërkimit shkencor 2021- 2025</i>

studentët për realizimin e këtyre objektivave.	
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>UET dhe njësia bazë organizojnë aktivitete që ndihmojnë stafin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>Strategjia e kërkimit shkencor 2021-2025</i></p>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Një nga objektivat e programit MSc në “Imazheri dhe Radioterapi”, është formimi teknikëve imazheristë dhe të radioterapisë me formim teorikopraktik që të jenë të aftë të përballojnë kërkesat për punësim në Shqipëri dhe tregun ndërkombëtar. Programi synon që të japë aftësi profesionale në ushtrimin e profesionit të teknikut radiolog. Edhe struktura mësimore dhe bashkëpunimi me IAL Europiane i përgatit për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>Marrëveshje bashkëpunimi</i></p>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Departamenti i Imazherisë mban kontaktet me urdhrin e infermierit me qëllim përmirësimin e programit si dhe merr feedback nga studentët në prag diplomimi në lidhje me elementët e nevojshëm për përmirësim.</p> <p><i>(Analiza e arritjes së objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxenit për programin e studimit Master I shkencave në Imazheri dhe radioterapi)</i> <i>(Takimi me studentet)</i></p>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	<p>Programi mësimor i MSc në “Imazheri dhe Radioterapi”, është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015 të “Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor në IAL” dhe Direktivës 2005/36/EU. Në çdo lëndë, përveç leksioneve dhe seminareve, ka numër të konsiderueshëm orë laboratorike me qëllim që studentët të aftësohen praktikisht. Programi ka edhe 12 kredite praktikë profesionale dhe 18 kredite praktika lëndore që zhvillohet në klinika apo institucione të ndryshme shëndetësore, çfarë bën të mundur dhënien e kompetencave profesionale. Numri i studentëve të regjistruar në program mundëson zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave në grupe të vogla, çfarë mundëson dhënien dhe kontrollin maksimal të aftësive praktike.</p>

	<i>Plani mësimor i programit tëstudimit</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p> <p><i>- Në programin mësimor përfshihen lëndë që japin bazat e kërkimit shkencor si dhe siguron mbështetje për studentët në përgatitjen e provimit të diplomës, për të realizuar objektivat e programit të studimit në kërkim shkencor.</i></p> <p><i>-Departamenti i Imazherisë mbështet projektet kërkimore shkencore përmes planit kërkimor shkencor vjetor, që miratohet në Senatin Akademik</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarat, ushtrimet, laboratorët, praktikatat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj.</p> <p>Departamenti organizon trajnime apo workshope për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Në kuadër të mësimin online institucioni ka realizuar seminarat apo leksione të hapura online.</p>

	<p>Ndihmë në këtë drejtim jep Platforma e edukimit në distancë e cila krijonë gjithashtu mundësi për prezantimin e veprimtarive laboratorike që zhvillohen në institucion. Kjo metodë ndihmon studentët të ndjekin në kohë reale dhe të jenë interaktive gjatë zhvillimi të saj.</p> <p><i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik i përzgjedhur nga institucioni ka përgatitje të lartë akademike. Gjithashtu ai përpiket të identifikojë sa më herët çështjet problematike të studentëve dhe kontribuon në zgjidhjen e tyre në bashkëpunim me koordinatorin e departamentit dhe përgjegjës të departamentit.</p> <p>Me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies institucioni organizon vazhdimisht trajnime për personelin akademik me tematika pedagogjike.</p> <p><i>CV e stafit akademik</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnime, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, Departamenti ofron metoda pedagogjike fleksible përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj.</p> <p><i>Rregullore e FSHMT</i> <i>Rregullore e departamentit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentin mendimin krijues, atë</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënien përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënien. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i Departamentit të Imazherisë, përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnime, si dhe organizon aktivitete trajnime brenda departamentit.</p>


<p>kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p><i>GVJ evidentoi prezencën e ulët të stafit akademik efektiv të specializuar në Imazheri dhe Radioterapi. Kjo sjell ngarkesën e lartë të tyre në mbulimin e procesit mësimor si në Master Shkencor ashtu edhe në Bachelor në Imazheri. GVJ Inkurajon intencionin të marrë masat e nevojshme për shtimin e stafit akademik të specializuar në fushën e ngushtë imazherike.</i></p> <p><i>(Vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në UET funksionon Këshilli Studentor, i cili ka përfaqësuesit e tij në Senat, por gjithashtu është një aktor i rëndësishëm për ngritjen e zërit të studentëve në lidhje me kërkesat e tyre. UET dhe Këshilli Studentor bashkëpunojnë dhe në mënyrë periodike përmes pyetësorëve, vlerësojnë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies, si dhe ti reflektojnë ato në përmirësimin e metodologjisë. Rezultatet e anketimit janë paraqitur në Raportin vjetor të KSBC.</p> <p><i>Dokument SCL teaching and assessment policy</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirëimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Struktura e sigurimit të cilësisë dhe këshillimit të karrierës është njësia që koordinon punën midis njësive kryesore dhe atyre bazë, për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. NJSBC përmes metodave të ndryshme, duke përfshirë edhe anketimin e studentëve, bën të mundur që procesi i përmirëimit të përfshijë edhe mendimin e studentëve. Me qëllim eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Rregullore e NJSBC</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p>

	<p>- Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien</p> <p>- Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni dhe njësitë kryesore kanë hartuar dhe zbatojnë aktet rregullatorë të cilat koordinojnë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive.</p> <p>Universiteti informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara edhe në faqen e Internetit të Universitetit. Rregullorja e institucionit parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është një shumatorë e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar.</p> <p>UET ka hartuar dhe miratuar rregulloren e posaçme për mësimdhënien online dhe testimin e njohurive.</p> <p>Komunikimi i rregulloreve nëpërmjet platformës online siguron informimin e plotë të studentëve.</p> <p><i>(Syllabyset e lëndës);</i> <i>(Rregullore provimesh);</i> <i>(Udhëzues për provimet)</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënit të lëndës, librin shkollor dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj.</p> <p><i>Syllabuset e lëndëve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs.</i></p>




Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas shqyrtimit të syllabus-eve të lëndëve në programin studimor, si dhe takimit me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes shumatoreve të formave kryesore të vlerësimit si: provim i ndërmjetëm, prezantim, laborator, provim përfundimtar, pjesëmarrje aktive. <i>(Syllabuset e Lëndëve); (Takimi me studentët)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që: - UET garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Ky proces mbështetet dhe bazohet në rregulloren e NJSBC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të programit të studimit, konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit të studimit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet përfundimtare. Provimet e ndërmjetme apo vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë semestrit me miniteste, projekte, detyra kursi sipas syllabusit përkatës. Programi i studimi ka profil të theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit përveç njohurive, bazohet dhe në aftësitë profesionale. <i>(Rregullore e programit të studimit); (Programi i studimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi me të paktën dy pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimit në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë




<p>abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>bërë të ditur studentëve në platformën online. UET ka hartuar edhe platformën e provimeve online, rregullore që i është bërë e qartë edhe studentëve që në fillim të vitit akademik. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit.</p> <p><i>Rregullore e FSHMT</i> <i>Rregullore programi studimi</i> <i>Programi i studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar rregullores së programit si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga pedagogu i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>(Rregullore programi studimi)</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se në fletën e provimit pasqyrohen pikët e grumbulluara si dhe komentet përkatëse për gabimet e bëra. Komentet i përcohen edhe studentit, i cili ka të drejtë ti dijë ato. Në fund të ballafaqimit me studentët pedagogu bën vlerësimin përfundimtar të studentit.</p> <p><i>(Rregullore programit te studimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën.</p> <p>Studenti penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij.</p> <p><i>(Rregullore FSHMT)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Afatet e përfundimit të vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura edhe në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet në përgjithësi maksimalisht një javë pas periudhës së provimit përfundimtar.</p> <p><i>(Dokumenti mbi funksionimin e sekretarjes mësimore)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të</p>	<p>Studentëve u ofrohet e drejta të ankimojnë rezultatet e tyre duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë Departamentit përkatës. Departamenti ngre një komision të posacem i cili rivlerëson tezën</p>

vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	në prani të studentit dhe pedagogut të lëndës. I gjithë ky proces dokumentohet në department. <i>(Rregullore e UET, rregullore e FSHMT)</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nuk referohen raste ankimi nga ana e studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve përfundimtare dhe nuk ka pasur asnjë ankimin drejtuar Përgjegjësit të departamentit. <i>(RVB); (Takimi me studentet)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe realizohet me provim me shkrim dhe me detyra, projekte/ese, raste studimore, etj;</i> - <i>Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde është i ndërtuar në mënyrë që të jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimet;</i> - <i>Institucioni angazhohet në zbatimin e rregulloreve të fakultetit në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të studentëve duke mbështetur fort vlerësimin sipas meritokracisë;</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.

Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Plani i programit mësimor rendit lëndë e module të cilat përputhen me nivelin e ciklit të dytë të programit të studimit. Krahas njohurive shkencore teorike,

	<p>programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Për zhvillimin e aftësisve të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane dhe sociale janë përfshirë tema të caktuara brenda syllabuseve të ndryshëm në kurrikulën e këtij program. Gjithashtu në Institucion ka një kabinet të teknologjisë dixhitale e cila aksesohet lehtësisht nga studentët e këtij program.</p> <p><i>(Plani mësimori programit); (Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde përmbledhen analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton student sipas syllabuseve të çdo lënde. Bazuar në këto informacione të mbledhura, pedagogu i lëndës duhet të rishikojë çdo vit syllabusin dhe nisur nga analiza e zhvillimit të mësimin, sygjeron ndryshime me synim përmirësimin e pritshmërive nga studentët.</p> <p><i>(Rregullore e programit të studimit MSh Imazheri dhe radioterapi)</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”, kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët mjekësore, si dhe në praktikat profesionale.</p> <p>Diskusimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Master i Shkencave në Imazheri dhe Radioterapi.</p> <p><i>(Syllabuset e Lëndëve)</i> <i>(Kurrikula e programit të studimit)</i></p>

institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, se stafi akademik i programit, ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës. Stafi akademik mbështetet nga Departamenti dhe Universtiteti për realizimin e aktiviteteve të ndryshme si leksione të hapura, konferenca, workshope etj.								
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera. Studentët e FSHMT prej vitesh marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit. <i>(Rregullore e UET)</i>								
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i> <i>-Institucioni ka kuadër rregullator që siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet bazuar në programin e parashikuar në syllabusin e lëndës, dhe kryhet bazuar në rregulloren e programit të studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Procedura për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht. <i>(Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit)</i>





<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Informacione dhe udhëzimet për mbrojtjen e diplomës janë vënë në dispozicion të studentëve dhe është e publikuar dhe në faqen online. Pedagogët përgjegjës përgatisin një program mbështetës për provimin përfundimtar. Në raste të caktuara pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët gjatë procesit të përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar.</p> <p><i>(Syllabuset e lendeve); (Programi i studimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Punimi i diplomës bëhet duke përgatitur material shkencor i cili përfshin njohuritë e marra gjatë të dy viteve akademike me orientimin kryesor drejt informacionit shkencor të dobishëm .</p> <p><i>(Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogët përgjegjës për studentët dhe temat e tyre të diplomës punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato në përgatitjen për provimin përfundimtar</p> <p><i>(Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Ky program studimi e realizon pothuaj gjithë pjesën e praktikave profesionale dhe laboratorike në kabinete radiologjike të cilët janë të lokalizuar në institucionet shëndetësore me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi. Universiteti asiston këto studentë në marrëveshje me udhëheqësit klinikë të cilët ndjekin studentët gjatë praktikave profesionale por edhe nën vëzhgimin e koordinatorit të programit.</p>
	<p><i>(Rregullore e programit të studimit);</i> <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i></p>

Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni përgjegjës për koordinimin e provimin të diplomës. <i>(Rregullore e fakultetit)</i>		
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë dhe kompletimin e 120 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Në përfundim të studimeve student pajiset me Diplomën përkatëse, certifikatën e notave si dhe me Suplementin e Diplomës. <i>(Rregullore e fakultetit)</i> <i>(Vizita në sekretari)</i>		
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin e përcaktuar, i cili u verifikua në sekretari gjatë vizitës. <i>Rregullore e sekretarisë</i> <i>Vizita në sekretari</i>		
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i> - <i>UET ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i>		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive,	UET dhe Departamenti i Imazherisë ka vendosur në dispozicion të studentëve dhe stafit pedagogjik salla leksioni me projektorë për dhënie të njohurive teorike, një laborator anatomie, një aparat




<p>garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>radiografi për stimulimin e ekzaminive, si dhe kishte kontrata bashkëpunim me disa institucione shëndetësore të përshtatshme për kryerjen e praktikës profesionale.</p> <p><i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>UET ka marrëveshje bashkëpunimi me klinikat shëndetësore nëpërmjet të cilave bën të mundur realizimin e praktikave profesionale cilësore, me qëllim përfitimin e njohurive dhe kompetencave profesionale në fushën e radiologjisë, dhe përgatitë studentët për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>Marrëveshje bashkëpunimi UET ne funksion te programit</i></p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Bazuar në "Planin mësimor i programit të integruar të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Imazheri dhe Radioterapi", praktikrat profesionale, zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe detyrimisht nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Praktika ndiqet personeli mbikqyrës, dhe në fund të praktikës realizohet provimi vlerësues I saj. Praktika profesionale ka 12 kredite ndërsa ajo lëndore 18 kredite (ECTS).</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Plani mësimor I programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në programin e studimit MSc në Imazheri dhe Radioterapi, ka vënë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve sallat leksioni dhe laboratorin paraklinik demonstrues.</i> - <i>UET ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale dhe përgatitur për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin që disponon si dhe takimet në Institucion konstaton se, Departamenti i Imazherisë është përgjegjës për programin e studimit “Master i Shkencave në Imazheri dhe Radioterapi”, Ky Departament ka aktivizuar 8 personel akademik efektiv (PAE - viti akademik 2024-25): pesë PAE të kategorisë profesor, dy PAE me PhD dhe dy me MSc në proces doktorimi. Po, kështu në stafin PAK, nga tre punonjës, dy prej tyre janë me PhD dhe një Master. GVJ vëren se ka ndryshime pozitive përse i përket shkallës së kualifikimit të personelit akademik të angazhuar ndër vite në këtë program studimi.</p> <p><i>GVJ konstaton se ka personel me nivelin e kualifikimit MSc janë të përfshirë në bërthamën e lëndëve apo moduleve të programit, që mendojmë se nuk kanë kualifikimin e duhur shkencor. Ky personel mund të aktivizohet vetëm në pjesën e praktikave profesionale.</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Tabelat përmbledhëse për anex – tabela 6.1-6.3;</i> <i>Dokumenti 11.1: Shembull thirrje për staf akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe takimeve në institucion, GVJ vëren se ngarkesa mësimore e programit të studimit mbulohet nga stafi i angazhuar.</p> <p><i>Ajo që konstaton GVJ se ka pedagogë që janë përgjegjës për një numër të madh lëndësh (6 të tilla) apo kreditesh mbi 25 kredite) në këtë program studimi. Një shpërndarje e tillë nuk është</i></p>

	<p><i>pedagogjike dhe shkencore, sepse në nivel të tillë program studimi, kërkohet një hierarki profesionale shumë specifike përsa u përket trajtimit të njohurive në aspektin teorik dhe klinik.</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Tabelat përmbledhëse për anex – tabela 4; tabelat 12- RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Ajo që vihet re është fakti që Institucioni ndër vite është munduar të plotësojë si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilësore stafin mësimdhënës në këtë program studimi. Kështu, kemi rekrutime stafi që janë më brenda fushës së programit mësimor dhe që kanë kualifikimin dhe eksperiencën e duhur. Por, mendojmë që është një proces që sapo ka filluar.</p> <p><i>Institucioni duhet të rrisë në sasi dhe cilësi stafin e angazhuar në këtë program studimi. Në takimin me Burimet njerëzore vumë re se mungonte kontrata me pedagogë të brendshëm..</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 11: Rregullore për burimet njerëzore.</i> <i>Tabelat përmbledhëse për anex –Tabelat 2;</i> <i>Dokumenti 11.1: Shembull thirrje për staf akademik.</i> <i>Dokumenti 11.1.1: Kërkesa drejtuar Rektori.</i> <i>Dokumenti 11.1.2: Kërkesa nga Departamenti.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm, sikurse dhe specialitetin dhe ngarkesën mësimore. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UET. Personeli akademik përzgjidhet nga Komisioni në përputhje me kriteret e përcaktuara nga njësia bazë.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_ struktura organizative aktuale _shqip.</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti 11:1: Shembull thirrje për staf akademik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p><i>Nga verifikimet e bëra, GVJ konstaton se Institucioni nuk disponon laboratorë të specifikuar për programin në fjalë, por shfrytëzon bashkëpunimet me Institucione të ndryshme për këtë.</i></p> <p><i>Takimet në Institucion.</i></p>

<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të disponueshëm dhe verifikimeve në Institucion, GVJ vëren se është Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila menaxhon të dhënat e personelit, duke krijuar Dosjen Individuale të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Po kështu, kjo zyrë mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti (Rregullore për burimet njerëzore);</i> <i>Dokumenti 11: Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.</i> <i>Dokumenti 11:1: Shembull thirrje për staf akademik.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka bashkëpunime me institucione të tjera me interes për zhvillimin e pjesës praktike të programit të studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”. Në rast të mungesës së personelit nga Departamenti zgjidhet një personel i jashtëm, supervisor. Supervizori angazhohet për realizimin e praktikave profesionale, ofron mbështetje për studentët për përmbushjen e detyrimeve dhe hartimin e raportit përfundimtar të praktikës. Ai gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të studentëve, duke plotësuar formularin e vlerësimit të studentit.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 11: Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore.</i> <i>Dokumenti Nr. 5: Rregullore e Universitetit Evropian të Tiranës, Neni 22</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë</p>	<p>GVJ konstaton se, edhe në bazë të takimit me studentet e këtij programi, në përgjithësi, ka një personel përgjegjës/pritës i studenteve në ambientin e Spitaleve Universitare dhe të tjera institucione, i angazhuar për realizimin e praktikave profesionale, që ofron mbështetje për studentët për përmbushjen e detyrimeve dhe hartimin e raportit përfundimtar të praktikës.</p> <p><i>Nga studentet u theksua se ka raste që kjo hallke mungon ose nuk funksionon.</i></p>

në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 32.1: Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.</i> <i>Dokumenti 32.2: B-I-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës (nga Studenti).</i> <i>Dokumenti 32.3: Dosje studenti praktike profesionale.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ vëren se ka përmirësim ndër vite përsa i përket cilësisë së stafit akademik për mësimdhënie në programin Master i Shkencave në "Imazheri dhe Radioterapi". Por Institucioni duhet të bëjë më shumë përsa i përket aktivizimit të stafit të specializuar në këtë program studimi. Vërehet një përqendrim shumë i madh lëndësh apo kreditesh në një lektor të vetëm. Po kështu, kemi aktivizim në mësimdhënie të stafit pa gradë shkencore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
		X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ konstatoi edhe në takimet në Institucion faktin që Institucioni ka garantuar mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies si salla leksioni dhe seminaresh, sallë veprimtarish, sallë mbledhjesh, laboratorë mësimorë dhe informatike, zyrë informacioni, mjedis për fotokopje dhe librari, bibliotekë. Edhe për studentet e programit në fjalë ishin të përcaktuara salla e leksioneve (1) dhe seminareve (1) përkatëse. Këto mjediset kishin strukturën e duhur për zhvillim mësimor.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes	<p>Sipas konstatimeve në Institucion, GVJ konfirmon se UET ka në përdorim 5 laboratorë mësimorë informatike, si dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Po kështu, Institucioni ka investuar në sisteme teknologjike si UET LMS, të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor.</p>

<p>përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 46: Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Institucioni nuk zotëron laboratorë që i përshtaten natyrës së programit të studimit, por aspektin praktik studentët e zhvillojnë nëpër institucione të tjera, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Në dokumentacionin që zotëron GVJ, jepet lista e këtyre institucioneve, por nuk ka informacione për kohëzgjatjen e këtij bashkëpunimi.</i> <i>GVJ, në takime me studentët konstatoi se studentët bënin praktikë profesionale pranë qendrave mjekësore vetëm për pjesën e Imazherisë, por nuk bënin praktikë për pjesën e Radioterapisë. Kjo përbën një problem serioz në formimin profesional të studentëve.</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti Nr. 32: Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale.</i> <i>Dokumenti 34: Marrëveshje bashkëpunimi – Lista UET.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 5 laboratorë mësimorë informatike të cilët janë në dispozicion edhe për programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe laboratorë me simulime online, Inovation Lab me 20 PC.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti: RVB;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore,</p>	<p><i>Institucioni UET nuk ka struktura të veta spitalore, por ka marrëveshje bashkëpunimi me struktura të tilla publike dhe jopublike (private), ku studentet kryejnë praktikat profesionale dhe veprimtari të tjera në kuadrin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Tabela 5: Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale: Dokumenti Nr. 32: Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale.</i> <i>Dokumenti 34.1: Marrëveshje bashkëpunimi UET në funksion të programit.</i> <i>Dokumenti 34.2: Memorandum Bashkëpunimi - UET.</i></p>

institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.									
Konkluzione	<p><i>GVJ vëren se institucioni ofron ambiente të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, dhe të pajisura me teknologji. Laboratorët dhe auditorët janë funksionale dhe të pajisura me aparaturat dhe softuerët e nevojshëm për zhvillimin e mësimin praktik dhe teorik. Infrastrukturat e dedikuara për programin e studimit mundësojnë zhvillimin teorik të programit mësimor. Pjesa praktike e këtij programi zhvillohet neper institucione të jashtme, të specializuara.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që është urgjente domosdoshmëria që studenteve t'u krijohet mundësia të bëjnë praktike profesionale për pjesën e Radioterapisë, si një aspekt shumë i rëndësishëm i formimit profesional të studenteve. Mendojmë se çënohet formimi profesional i tyre.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të <i>parashikuara</i> në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Biblioteka e UET disponon literaturë që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse, duke përfshirë edhe programin e Masterit të Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”.</p> <p>Po kështu, studentet kanë mundësi të shfrytëzojnë burimet online për literaturën, si Sage&EBSCO, Questia, ASTM Compass, Edward Elgar Publishing-Elgar Online Platform, RESEARCH4LIFE, në të cilat është abonuar institucioni.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti Nr. 45: Inventari i teksteve MSH Imazheri dhe Radioterapi;</i> <i>Dokumenti Nr. 42: Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës;</i> <i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse - Tabela Nr. 17:</i></p>

	<i>Dokumenti Nr. 45.1: Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ, gjatë vizitës në Institucion, konstatoi se njësia përgjegjëse e programit të studimit ka komunikim me Përgjegjësin e Bibliotekës për përditësimin dhe pasurimin e fondit të Bibliotekës me literaturën e nevojshme për stafin akademik dhe studentet. <i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti Nr. 45: Inventari i teksteve_ MSH Imazheri dhe Radioterapi;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas konstatimeve të GVJ, në UET ekziston një sallë e bibliotekës 40 m ² dhe salla e leximit 50 m ² me 41 vende leximi. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online në të cilat është abonuar institucioni. Duke patur parasysh kapacitetet njerëzore të këtij universiteti, <i>sugjerojmë që të rriten hapësirat e punës së Bibliotekës.</i> <i>Takimet në Institucion;</i> <i>RVB</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra dhe CD në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Aksesimi i literaturës së programit nga studentët, garantohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, fizik dhe elektronike. Biblioteka funksionon me orar të gjatë pune dhe fleksibel për studentet. <i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.</i> <i>Dokumenti 45.1: Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</i> <i>ANEKS: Tabelat përmbledhëse - Tabela Nr. 17:</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Sipas verifikimeve të bëra nga GVJ, rezultoi se abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia, dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Aksesimi i studentëve është pa pagesë. <i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti Nr. 45.1: Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës.</i>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC/wi-fi në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat online të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), një rrjet komunikimi i vendeve të Evropës Juglindore. Veprimtaria dhe mënyra e funksionimit dhe ofrimit të shërbimeve të Bibliotekës është e rregulluar me dokument të veçantë.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 45.1: Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstaton se Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëne-Premte 9:00-20:00, e Shtunë 9:00:17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur, procedure që është e sanksionuar në dokumentin përkatës.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti Nr. 45.1: Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Referuar rregulloreve të institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se biblioteka e UET, së bashku me njësitë përgjegjëse të programit, monitoron dhe raporton rregullisht për cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës. Ky proces përfshin përditësimin e titujve kryesorë të disponueshëm për programet e studimit, si dhe monitorimin e shkallës së shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij online nga studentët dhe personeli akademik.</p> <p>Analiza e përdorimit të sallave të studimit dhe përpjekjet për pasurimin e vazhdueshëm të literaturës, si dhe identifikimi i kërkesave për tituj të rinj, janë pjesë e një procesi dinamik për të garantuar cilësinë dhe përmirësimin e shërbimeve bibliotekore.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti Nr. 45.2: E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë</i> <i>Dokumenti 45.1: Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës.</i> <i>Dokumenti 42: Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (mungon).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se Universiteti ka krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e bibliotekës dhe burimeve akademike nga studentët,</p>

	<p>duke siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë në fondet fizike dhe online.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me teknologji moderne dhe ofron orare shërbimi të përshatshme, duke përbushur nevojat e studentëve dhe të personelit akademik. GVJ rekomandon pasurimin e mëtejshëm të fondit të bibliotekës edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të programit të studimit. Po kështu, rekomandohet rritja e hapësirave fizike të Bibliotekës.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UET administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është sistemi UMIS. Ky sistem përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin automatik me anë të email-it ose me mesazhe për aktivitete të ndryshme, regjistrimi në kurse apo programe të ndryshme.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 46: Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</i> <i>Dokumenti 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin që zotëron si dhe verifikimet në Institucion, vëren se personeli akademik dhe ai ndihmës akademik përdorin sistemin UET LMS, në të cilin janë të përfshira të dhëna që lidhin veprimtarinë mësimore, si seminare, leksione, detyra kursi, laboratorë, vlerësimet akademike të studentëve, etj. Ky sistem, gjendej në çdo zyrë të stafit akademik, në kompjuterët e stafit, me akses nga ky i fundit.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun.</i></p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni UET, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS.</p> <p>Sistemi jep mundësinë që përpara logimit çdo pedagog apo student të mund të shohë të gjitha lëndët që ofrohen në universitet; Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët. Ndërsa studentët kanë akses në informacionin dhe materialet që lidhen me programin e tyre të studimit.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun</i> <i>Dokumenti 46.3: UET LMS Guidë për studentët.</i> <i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni UET, ka në funksionim sistemin e menaxhimit të integruar LMS, i cili është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog.</p> <p>Funksioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, etj.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 46.2: UET LMS Guide per pedagogun.</i> <i>Dokumenti 46.3: UET LMS Guide për studentët.</i> <i>RVB;</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platforma LMS që përdor Institucioni nëpërmjet procesit të përpunimit të të dhënave të aksesimit nga palët e interesuara, është edhe një mjet eficient në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 46.2: UET LMS Guidë për pedagogun.</i> <i>Dokumenti 46.3: UET LMS Guidë për studentet.</i> <i>RVB;</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin</p>	<p>GVJ nga takimet në Institucion konstaton se UET përdor faqen zyrtare online të tij. Kjo faqe përmban informacion të plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin,</p>

akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	organigramën; guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, së bashku me biografi të detajuara të personelit akademik, etj. Po kështu përdoren edhe rrjete sociale, si Instagram dhe Facebook. <i>Takimet në Institucion;</i> <i>Faqja zyrtare e UET: www.uet.edu.al.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Institucioni ka krijuar një sistem efikas për komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit. Sistemi i menaxhimit mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni të lehtë ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, duke përmirësuar procesin mësimor. Informacionet lidhur me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të disponueshëm edhe në gjuhën shqipe dhe angleze, duke siguruar akses të barabartë dhe transparencë për të gjithë përdoruesit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Universiteti UET harton një raport financiar të detajuar për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky raport përfshin një analizë të shpenzimeve dhe burimeve financiare të nevojshme për mbështetjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Në bazë të buxhetit financiar të miratuar çdo vit, përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve, duke saktësuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Sipas dokumenteve dhe takimeve në Institucion rezulton se burim kryesor financimi për programin janë tarifat e ndryshme të shkollimit, kontributi nga donacionet ku UET është pjesëmarrës, shërbimet e ndryshme, etj. Nga ana tjetër janë edhe kostot e lidhura me programin si: shpenzimet e personelit akademik, kostot për student, mirëmbajtja e mjediseve etj.

	<p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 50.1; 50.2; 50.3; 50.4: Pasqyrat Financiare dhe auditit 2022-23-24 me shënime.</i> <i>RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni respekton standardet e hartimit të planit financiar dhe raportimit financiar. Plani i financimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase dhe të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 50.1; 50.2; 50.3: Pasqyrat Financiare 2022-23-24 me shënime.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni UET i nënshtrohet procesit të auditimit çdo vit, konform legjislacionit në fuqi. Kontrolli i auditimit të brendshëm realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm ndërsa kontrolli i auditimit të jashtëm të përzgjedhur nga Ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare, duke nxjerre pasqyrat financiare. Këto auditime gjenerojnë raporte që ndihmojnë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë në programin e studimit.</p> <p><i>Takimet në Institucion,</i> <i>Dokumenti 50.1; 50.2; 50.3: Pasqyrat Financiare 2022-23-24 me shënime.</i> <i>RVB.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni, çdo fillim viti referon gjendjen financiare të institucionit për programin e studimit pranë njësisë përgjegjëse të programit të studimit. Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve nga Institucioni.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>RVB</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se, analizat sistematike të efikasitetit dhe kostove financiare sikurse dhe auditimet e brendshme dhe të jashtme i mundësojnë UET-së marrjen e vendimeve optimale menaxheriale për të siguruar stabilitet dhe vijueshmëri financiare për ofrimin e çdo programi studimi.</p> <p>Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 50.1; 50.2; 50.3: Pasqyrat Financiare 2022-23-24 me shënime.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se Institucioni UET ka një sistem financiar që mbështet programet e studimit dhe siguron kushte të përshtatshme infrastrukturore dhe akademike. Planifikimi i detajuar i kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare siguron realizimin e procesit mësimor dhe përmbushjen e nevojave të programeve të studimit për një cikël të plotë. Pasqyrat financiare dhe auditimet vjetore dëshmojnë një gjendje të qëndrueshme financiare, e cila kontribuon në përmirësimin e cilësisë dhe infrastrukturës së universitetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ, bazuar në vizitën në Institucion dhe dokumenteve që disponon, konstaton se Institucioni i UET, nëpërmjet statutit dhe rregulloreve të tij, ndërton dhe zbaton politikat dhe procedurat që përfshijnë gjithë ciklin akademik të programit të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto politika përfshijnë procedurat e pranimit, zhvillimit të studimeve, mbështetjes akademike, si dhe diplomimit, duke siguruar që të gjithë studentët të trajtohen në përputhje me standardet ligjore dhe akademike. Një sistem i tillë garanton transparencën dhe ndihmon në mbështetje të zhvillimit të një procesi akademik efikas dhe të rregullt. Rregullorja e Programit përcakton procedurat e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, si dhe procesin e diplomimit, duke hartuar politika që sigurojnë barazinë mes studentëve.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 27.1: Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</i> <i>Dokumenti 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni, bazuar në Rregulloren e UET mbi “Të drejtat e studentit”, si dhe “Rregullorja Mësimore”, për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit ndjek politika dhe procedura që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i></p>

	<p><i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 28: Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Universiteti Evropian i Tiranës (pra edhe Fakulteti, FSHMT) harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të qarta dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve Master i Shkencave në "Imazheri dhe Radioterapi". Këto kritere janë në përputhje me ligjin dhe udhëzimet përkatëse. Institucioni bashkëpunon me strukturat përkatëse duke siguruar që procesi i pranimit të jetë i drejtpërdrejtë, transparent dhe i rregullt. Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, publikohen në faqen e UET, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë kontakteve me ta, sikurse dhe reflektohen në dokumentet përkatëse.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni UET ka përcaktuar dhe publikuar kritere dhe procedura të qarta për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve në këtë program studimi, përparimin e tyre gjatë kursit të studimit, transferimin e krediteve, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimin e dijeve dhe procesin e diplomimit. Këto procedura janë të kuptueshme dhe të aksesueshme për të interesuarit, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për studentët.</p> <p>GVJ vëren se këto procedura u bëhen të ditura të interesuarve gjatë kontakteve në institucion, por janë gjithashtu të aksesueshme dhe në sistemin online të UET.</p> <p><i>Takimet në Institucion.</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</i></p>

	<i>Dokumenti 28: Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni UET/FSHMT, përpara fillimit të çdo viti akademik, informon të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimit. Ky informim është i detajuar dhe i aksesueshëm për të gjithë, duke siguruar që kandidatët dhe studentët e mundshëm të kenë njohuri të plota rreth kushteve dhe kërkesave të programeve përkatëse. Ky proces garanton qasje të barabartë për të gjithë. <i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 48: Vendim nr. 10, date 06.07.2023 Për miratimin e dokumentit Politika dhe procedurat e informimit publik.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se në dokumentet e disponueshëm, siç është Rregullorja e MSH, nuk ka cilësime për kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidateve me aftësi të veçanta. <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 27.1: Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</i> <i>Dokumenti 53: Ligji Nr. 80, 2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstaton se, institucioni harton dhe zbaton kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit në programin e studimit, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet në Institucion konstatohet se nga ana e UET parashikohen kuota të veçanta për regjistrimin e shqiptarëve nga trojet. Regjistrimi i studentëve shqiptarë nga trojet bëhet mbështetur në udhëzimet e MAS. Po kështu, edhe transferimi i studenteve nga shkolla të tjera bëhet sipas procedurave të parashikuara me dokument të veçantë. <i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 27.1: Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për	Bazuar në dokumentacionin që disponon dhe takimet në Institucion, GVJ konstaton se UET ofron bursa të plota ose të pjesshme studimi në bazë të disa kriterëve, me synimin për të

të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	nxitur rezultate sa më të larta në studime, si dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm social, duke u ardhur në ndihmë shtresave të diskriminuara dhe në nevojë.		
	<i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti Tabelat përmbledhëse_Anex_RVB</i>		
Konkluzione	GVJ vëren se Institucioni ka një sistem të pranueshëm dhe efikas për pranimin e studentëve në këtë program studimit të nivelit të dytë, duke përfshirë politika dhe kritere të përcaktuara për kategoritë e ndryshme të kandidatëve, përfshirë nga shtete të tjera dhe ato nga shtresat në nevojë. Kjo si për aspektin e pranimin në program ashtu edhe mundësitë e financimit. Institucioni publikon dhe komunikon me transparencë kriteret dhe procedurat përpara çdo viti akademik, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë studentët potencialë. Institucioni duhet të qartësojë kriteret për personat me aftësi të veçanta.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ vëren se Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Procedura janë të përcaktuara në Rregulloren e UET si dhe Rregulloren e MSH. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentet, duke zotëruar fushën studentore, kanë mundësi të informohen për vlerësimin për secilën lëndë të zhvilluar deri në periudhën aktuale, si dhe për numrin e krediteve të mbledhura. <i>Takim në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore MSH Imazheri dhe Radioterapi.</i>

	<i>Dokumenti 7.2: Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Institucioni i UET, informimin e bën nëpërmjet Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me Departamentin, ku studentët marrin informacioni dhe mbështetjen e nevojshme. GVJ konstaton se këto struktura bëjnë edhe vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet. Institucioni pranon transferime të studentëve sipas rregulloreve dhe kriterëve të mirëpërcaktuara.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton se, informimi në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të përcaktuara në rregulloren e Programit të Studimit. Ky informim behet edhe çdo fillim viti akademik përmes pedagogut të lëndës për çdo lëndë të programit të studimit. Pjesë e sillabusit është edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 19: Syllabuset e lëndëve (Anglisht 2024-2025) të ofruara në programin e studimit MSH Imazheri dhe Radioterapi.</i></p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Referuar rregullores së institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se Universiteti Europian i Tiranës, informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Kjo gjë behet në fillim të ciklit të studimeve, ku përgjegjësi i programit së bashku me koordinatoren informon studentët mbi të gjitha hapat dhe fazat e diplomimit.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 10: Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</i></p>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura	<p>GVJ konstaton se Institucioni i ka mirëpërcaktuar në rregulloret përkatëse procedurat dhe aktivitetet që duhet të organizohet nga institucioni në lidhje me informimin e studentëve. GVJ vëren se organizohen ture informimi neper shkolla, Open Day, etj., për këtë qëllim. Mendojmë që ky proces informimi i detajuar dhe</p>

për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	transparent ndihmon studentët të bëjnë zgjedhje të pranuar dhe përgatiten për programet e studimit në institucion. <i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i>		
Konkluzione	GVJ vëren se Universiteti European i Tiranës ndjek një proces të qartë dhe të hapur për informimin e studentëve dhe të interesuarve në lidhje me kriteret dhe procedurat e ndryshme akademike që zbatohen në këtë institucion. <i>Institucioni siguron transparencë për kriteret e përparimit akademik, vlerësimit, punimit të diplomës dhe diplomimit, duke ofruar udhëzues të detajuar dhe duke organizuar takime informuese për studentët e ardhshëm.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se në UET, informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet disa formave, siç janë këshillimi me stafin akademik në momentin që ata interesohen për programet e studimit; kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj studentit; Rregullores mësimore të programit të studimit. Një informacion i plote gjendet edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”. Ky informacion gjendet edhe në sistemin online të Institucionit. <i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 46.3: UET LMS Guidë për studentet.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe	GVJ konstaton se Institucioni, nëpërmjet strukturave përkatëse siguron informacion të plotë dhe të aksesueshëm për studentët lidhur me lëndët dhe modulet përmes udhëzuesve të detajuar që

<p>dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>përfshijnë objektivat, përmbajtjen, metodat e vlerësimit dhe aktivitetet formuese. Ky informacion është i disponueshëm në katalogët akademikë, materialet online në platforma si UET-LMS; si dhe në faqen e internetit të universitetit www.uet.edu.al.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ vëren se Tutoriati dhe këshillimi akademik në rang institucioni, siguron jo vetëm informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit por edhe mbështetjen institucionale për orientimin në Tregun e Punës. Institucioni përdor mekanizma të ndryshëm për këtë qëllim: Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit, pra edhe për programin e Masterit Shkencor në Imazheri dhe Radioterapi; Bordet e tregut të punës - të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Një formë tjetër është edhe organizimi i panairëve të punës dhe aktivitete me aktorë nga tregu i punës.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i> <i>Dokumenti 12.1. Bordi i Tregut të Punës DI.</i> <i>Dokumenti 12.2: Short Bio e anëtarëve të BTP.</i> <i>Dokumenti: Dita e Biznesit në UET</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni ofron informacion të përditësuar dhe të detajuar për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë oraret e ligjëratave, praktikat dhe aktivitete të tjera akademike. Ky informacion është i disponueshëm përmes platformave online, si UET-LMS, dhe është gjithashtu i shpërndarë nëpërmjet tabelave informuese. Po ashtu, studenti ka akses në informacion për logjistikën e procesit mësimor si dhe Infrastruktura përkatëse: si bibliotekat, laboratorët dhe pajisjet teknologjike, që mendojmë se janë gjithashtu të dokumentuara dhe të aksesueshme për studentët, duke siguruar kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore_MSH_Imazheri dhe Radioterapi.</i></p>




	<i>Dokumenti: 46.3: UET LMS Guidë për studentet.</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton se Institucioni zotëron Sistemin e Vlerësimit të Brendshëm të Menaxhimit, i cili bën të mundur pasqyrimin dhe administrimin e informacionit, dokumentacionit duke e vënë atë në dispozicion të studentit, i cili e akseson në çdo kohë. të gjitha dokumentet ndodhen dhe mund të shkarkohen sa herë është e nevojshme, në sistemin e menaxhimit UMS në formën online. Aksesimi për aktivitetin mësimor të studentëve, mund të behet edhe nga zyrat e IT. <i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET.</i> <i>Dokumenti 46.3: UET LMS Guidë për studentet.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti Europian i Tiranës ka një sistem të strukturuar dhe për informimin e studentëve në lidhje me mundësitë e ofruara gjatë procesit mësimor dhe mbështetje të vazhdueshme për orientimin drejt tregut të punës.</i> <i>Institucioni siguron informacion të plotë dhe të përditësuar për lëndët, modulet, aktivitetet formuese dhe mundësitë e zhvillimit profesional, duke ofruar udhëzues të detajuar dhe platforma online të aksesueshme për studentët, si UET-LMS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton se Institucioni siguron mbajtjen dhe përditësimin e statistikave vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar për këtë program studimi, megjithëse është një program me histori 5 vjeçare. Këto të dhëna përfshijnë informacion të detajuar mbi pranimin e studentëve, arritjen e përfundimit të studimeve dhe diplomimit. Po kështu, mbahen të dhëna edhe për punësimin e studenteve pas diplomimit. Në këtë rast është zyra e ALUMNI që vepron. Nëpërmjet këtyre të dhënave, institucioni monitoron dhe vlerëson suksesin e programit akademik dhe zotëron informacion të

	<p>rëndësishëm për planifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave akademike, në lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 27: Cilësia në hyrje dhe dalje MSH SHMT.</i> <i>Dokumenti 29: Monitorimi i ecurisë së studenteve, diplomimit dhe punësimit të tyre (Tabela 23).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas informacioneve që zotëron GVJ, rezultojnë se, Institucioni disponon statistika të plota mbi ecurinë e studentëve, duke përfshirë edhe ato për programin e Masterit të Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi”. Rekordet janë të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë ç’regjistruar, si edhe studentët e diplomuar për secilin program studimi.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike.</p> <p>Numri i studentëve për 3 vitet e fundit akademike janë si më poshtë:</p> <p>Va: 2022-2023 28 studentë; Va: 2023-2024 45 studentë; Va: 2024-2025 60 studentë;</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Tabela 21, aneks tabelat përmbledhëse</i> <i>Dokumenti 27: Cilësia në hyrje dhe dalje MSH SHMT.</i> <i>Dokumenti 29: Monitorimi i ecurisë së studenteve, diplomimit dhe punësimit të tyre (Tabela 23).</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konfirmon se Institucioni ka në funksionim Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS), një program informatike, për ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e bibliotekës, etj. Të dhënat menaxhohen nga personel i autorizuar, pranë zyrës së IT.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 46.1: Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ, nga vëzhgimi në Institucion, konstaton se Institucioni siguron një proces të rregullt kontrolli dhe monitorimi pranë të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin e informacionit. Përmes këtij procesi, institucioni siguron saktësinë dhe përditësimin e të dhënave, si dhe garantimin e cilësisë së informacionit dhe dokumenteve që përdoren për menaxhimin e proceseve akademike.</p> <p>Sipas të dhënave që disponon GVJ, është KSBC, si strukturë përgjegjëse që bën këtë kontroll.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.</i> <i>Dokumenti 30.1: Plani veprimit KSBC.</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i> <i>Dokumenti 46: Manuali i përdoruesit te sistemit UMIS.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe takimeve në institucion rezultojnë se është Zyra e Këshillimit të Karrierës ajo që mban kontaktet me studentët e diplomuar, nëpërmjet strukturës së UET, Alumni, dhe harton raporte periodike mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit të studentëve. Këto raporte i përcillen strukturave përgjegjëse të Institucionit për vlerësime dhe përpunime të mëtejshme.</p> <p><i>Nuk del e qartë nëse njësia bazë e MSH ka përgjegjësi për të hartuar raporte analitike në lidhje me problemet e mësipërme.</i></p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 17: Studimi për Tregun e Punës – FSHMT.</i> <i>Dokumenti 29: Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre (Tabela 23).</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se institucioni ka një sistem për mbledhjen, menaxhimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike. Por ajo që konstatojmë është se nuk qartësohet roli i njësive bazë që organizojnë këtë program studimit në lidhje me të drejtën dhe detyrimin për tu shprehur nëpërmjet relacioneve analitike mbi aktivitetin akademik të studentëve.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>





Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ Konstaton se Statuti dhe rregullorja e Institucionit parashikojnë përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë." Kështu, studentet kane përfaqësues ne Senatn akademik; KSBC, Këshilli i Etikes. Studentët organizohen në Këshilla Studentore.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti 30: Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas të dhënave qe disponojmë, UET garanton përfshirje të studentëve në vendimmarrje (Këshilli i Studentëve), këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, vlerësim për pedagogët që u japin mësim etj. Këto të dhëna mbahen nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Një student i programit MSH është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti.</p> <p>Ky proces i përfshirjes ofron mundësi për studentët të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë akademike të programit mësimor dhe jo vetëm.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në</p>	<p>Sipas verifikimeve të bëra, GVJ konstaton se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Imazheri dhe Radioterapi" kanë mundësinë të përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Kjo sigurohet nëpërmjet mbledhjeve të hapura të departamentit, nëpërmjet sugjerimeve të ndryshme që ata bëjnë nëpërmjet UET LMS dhe Microsoft Teams. Mendojmë që sugjerimet dhe kontributet e studentëve reflektohen në ndryshimet dhe përmirësimet e programeve të studimit, duke</p>

<p>mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>garantuar që ato të përmbushin nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, si dhe të përmirësojnë cilësinë e procesit mësimor.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 6: Dokumenti F. IV-F. V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.</i> <i>Dokumenti 40: G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët 2022.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të disponuar dhe takimeve me studentët konstatohet se provimet janë të sekretuara duke u siguruar anonimiteti i studentit. Po kështu, edhe vlerësimet e rubrikave të tjera janë gjithashtu transparente dhe pas çdo vlerësimi studentët vihen në dijeni për pikët e tyre. Studentet kanë të drejtë të komentojnë rezultatet e fituara dhe të ndjekin të gjitha hapat e ankimimit për rivlerësim. Këto të drejta janë të përcaktuara në dokumentet rregullatore.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti 7: Rregullore MSH Imazheri dhe Radioterapi.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se, Institucioni ka krijuar një sistem ku studentët janë të përfshirë aktivisht në proceset vendimmarrëse dhe përmirësuese të programeve akademike, duke siguruar mundësi për të kontribuar në mënyrë konkrete dhe efektive.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përherëshme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ vëren se në Institucionin e UET vepron njësi e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, që është zyra e Kujdesit ndaj Studentit, e cila ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij. Gjithashtu, në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në Departament.</p>





	<p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ vëren se Universiteti Evropian i Tiranës, ka një sistem të strukturuar dhe funksional për mbështetje të studentëve gjatë gjithë procesit akademik. Ky sistem përfshin shërbime të informimit dhe këshillimit për studentët, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për çështje të lidhura me programin e studimit dhe përparimin akademik. Njësitë e dedikuara, si tutori akademik dhe departamenti përkatës, ndihmojnë studentët në monitorimin e progresit të tyre, u ofrojnë udhëzime për zhvillimin e programit mësimor dhe i asistojnë në zgjidhjen e çdo çështjeje që mund të lindë gjatë studimeve. Po kështu, studenti në UET mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës, për të marrë informacion dhe këshillim akademik.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se, në UET, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët në mënyrë periodike që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Sipas informacioneve të GVJ, ky shërbim është bashkërendues me punën që stafi akademik bën në këtë drejtim. Duke ndërmjetësuar interesimin dhe potencialet e të dyja palëve realizohen si kërkesat e tregut të punës ashtu edhe punësimi i studentëve të diplomuar.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 12: Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 27.2: Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas</p>	<p>GVJ, gjatë vizitë së zhvilluar në Institucion, konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat</p>

<p>diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të Programit të Studimit. Këto të dhëna Zyra ua vë në dispozicion studentëve nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm efektivë. Studentet janë pjesë e Bordeve të Tregut të Punës.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i> <i>Dokumenti 29: Monitorimi i ecurisë së studenteve, diplomimit dhe punësimit të tyre (Tabela 23).</i> <i>Dokumenti 38: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se Institucioni ka një sistem të pranueshëm dhe efikas për pranimin e studentëve në këtë program studimit të nivelit të dytë, duke përfshirë politika dhe kritere të përcaktuara për kategoritë e ndryshme të kandidatëve; siguron kontributin e studentëve në vendimmarrjet e ndryshme në funksion të rritjes së cilësisë dhe performancës së programit të studimit. Po kështu, GVJ konstaton se Institucioni ka mekanizmat e nevojshëm për të siguruar këtë gjë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin</p>	<p>GVJ vëren se, referuar RVB-së, Institucioni ka një strategji të zhvillimit të detajuar në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të</p>




<p>dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>mësimdhënies, të cilat janë të përshtatura për lëndët dhe modulet specifike të programit të studimit. Përdorimi i metodave inovative është i fokusuar në rritjen e angazhimit të studentëve dhe përmirësimin e rezultateve të mësimin, duke i mundësuar atyre të përvetësojnë njohuri në mënyrë më të efektshme dhe të zhvillojnë aftësi praktike dhe kritike. Kjo qasje e strukturuar kontribuon në përmirësimin e cilësisë akademike dhe ofron mundësi të reja për zhvillimin e studentëve në fushat e studimeve të tyre.</p> <p>Institucioni parashikon qartë si prioritet thelbësor trajnimin e personelit akademik për ndryshimin e stilit dhe metodave të mësimdhënies, si një investim dhe domosdoshmëri për zhvillimin e burimeve njerëzore. Krahas trajnimit të personelit akademik institucioni përshkruan si një tjetër alternativë për pasurimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, edhe angazhimin e personelit akademik në punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike e cila do t'i mundësojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET _struktura organizative aktuale _shqip RVB;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit dhe takimeve në Institucion, GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik i nënshtrohet në mënyrë periodike trajnimeve, testeve dhe vlerësimeve prej strukturave përgjegjëse në institucion për identifikimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative. Kjo nënkupton që institucioni ka mekanizma kontrolli për këto probleme. Kryesoret janë KSBC dhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës (varësi nga Rektori UET). Këto struktura hartojnë relacionet përkatëse, të cilat i dërgohen Rektoratit dhe/ose Departamenteve përkatëse;</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET _struktura organizative aktuale _shqip</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti 30.16: G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.</i> <i>Dokumenti 30.1: Plani veprimit KSBC</i> <i>Dokumenti 40: G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët _2022.</i></p>




<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se, e drejta e studentëve në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, sigurohet nëpërmjet vlerësimit me formular/pyetësor anonim nga studenti, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Strukturat përkatëse përpunojnë të dhënat e përfuara dhe vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si dhe secilit pedagog në mënyrë të personalizuar.</p> <p>GVJ konstaton se, Institucioni u jep mundësinë studentëve për trajtimin e ankimimeve, nëpërmjet mbledhjeve mujore të përbashkëta me stafin akademik.</p> <p>Studentet kanë të drejtën e reklamimit të rezultatit të provimit pranë Departamentit përkatës.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti 40: G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_2022.</i> <i>Dokumenti 40.2: D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve - Departamenti</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Referuar formatit të pyetësorit, GVJ konstaton se pyetësori për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve, që trajtohen në këtë program studimit, është një element i rëndësishëm për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor për studentët përmban një analizë të detajuar me gjetjet dhe konstatimet lidhur me performancën e pedagogëve dhe përmbajtjen e lëndëve.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC, apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p><i>Takimet në Institucion:</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_ struktura organizative aktuale_shqip</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 40: G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të</p>	<p>GVJ konstaton se, të gjitha rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit, lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, diskutohen në mbledhjet e departamentit duke u promovuar shembujt pozitiv dhe duke nxitur</p>

<p>praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>përmirësimin e mëtejshëm në mësimdhënie. Institucion siguron nëpërmjet akteve rregulluese mundësinë e përmirësimit të cilësisë nëpërmjet pjesëmarrjeve në struktura kërkimore jashtë institucionit si dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 28.5: Lista e projekteve, stafi nga departamenti i përfshirë në to, relacion.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka të ngritur sistemin për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, i cili përfshin përdorimin e pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve, si dhe vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i></p> <p><i>Institucioni siguron mundësi trajnimi dhe zhvillimi profesional për stafin akademik dhe mbështet mobilitetin ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve dhe projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ vëren se Institucioni ka bazën ligjore dhe strukturat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Pjesë e strukturave të veçanta për sigurimin e standardeve dhe cilësisë janë Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore si dhe Zyra e Kurrikulave.</p> <p>Ndërsa në nivel fakulteti dhe Departamenti (ku zhvillohet edhe programi i Masterit të Shkencave në Imazheri dhe Radioterapi) organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me anëtarë të përzgjedhur nga asambleja e personelit akademik si dhe me përfaqësues nga asambleja e studentëve.</p> <p>Mendojmë se ky mekanizëm i sigurisë së cilësisë është i projektuar për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të institucioneve</p>




	<p>akademike dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve të larta të arsimit.</p> <p><i>Takimet në Institucion</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_ struktura organizative aktuale_ shqip</i> <i>Dokumenti 30.2: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ vëren se, UET, ka ngritur dhe mban në funksion një Sistemi të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (KSBC), i cili siguron një strukturë të organizuar dhe efikase për menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Studentët përfshihen në proces nëpërmjet të qenit pjesë e KSBC, pjesëmarrjes në fokus grupe, pjesëmarrjes në vlerësimin online në platformën UET-LMS si dhe duke iu ofruar mundësia e trajtimit të ankimimeve të tyre.</p> <p>Bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm janë përfshirë në grupin e eksperteve si dhe në përmirësimin e cilësisë, referuar kjo pjesëmarrjes se Institucionit në projekte që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Takime në Institucion:</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i> <i>Dokumenti 30.4: Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.</i> <i>Dokumenti 30.18: Fisha e projektit Enchase</i> <i>Dokumenti 30.19: Fisha e projektit QAINAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerëimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se, Universiteti Evropian i Tiranës përdor një sërë mekanizmesh për të siguruar cilësinë në arsimin e lartë. Institucioni i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin periodik Institucional. Përveç vlerësimit të jashtëm, institucioni angazhon gjithashtu procese të brendshme që fokusohen në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të cilësisë, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe të studentëve. Kjo ndikon në ruajtjen dhe përmirësimin e performancës akademike të institucionit.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i> <i>Dokumenti 54: Urdhër Nr.648, date 11.10.2018 Për Hapjen e Programit Msc IMAZHERI dhe RADIOTERAPI</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se, Institucioni përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për të pasqyruar gjendjen aktuale, arritjet dhe dobësitë në këto fusha. Këta tregues janë të integruar në aktet rregullatorë të institucionit dhe shërbejnë si një mjet efikas për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj. Nëpërmjet përdorimit të këtyre treguesve, institucioni është në gjendje të identifikojë fushat ku është arritur sukses dhe ato ku nevojiten përmirësime.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip</i> <i>Dokumenti 5: Rregullore UET</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>Dokumenti 30.2: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka ngritur një sistem efikas për përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët ndihmojnë në pasqyrimin e gjendjes aktuale dhe identifikimin e arritjeve dhe dobësive.</p> <p>Përmes këtyre treguesve, institucioni është në gjendje të nxisë arritjet më të mira, duke motivuar studentët dhe stafin akademik për të arritur nivele të larta të performancës dhe duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm në programet e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor</p>	<p>GVJ, nga dokumentacionin që disponon si dhe nga vizita në institucion, konstaton se UET përgatit dhe shpërndan në formën e</p>




<p>mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Kjo nënkupton që ekzistojnë mekanizmat për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Mekanizmat përfshijnë KSBC, përgjegjësit e programit të studimit, koordinatorët përkatës si dhe Bordet e tregut të punës. Gjatë vlerësimit të raporteve të hartuara nga struktura, identifikohen arritjet dhe dobësitë, ndërsa praktikave dhe arritjet më të mira motivojnë zhvillimin e mëtejshëm të programit. Njëkohësisht, bëhet një planifikim për masat për përmirësim, duke siguruar që procesi të mbetet i qëndrueshëm dhe të rritet cilësia e programeve.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 13: Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave.</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i> <i>Dokumenti 30.5: Metodologjia e punës së KSBC provimet.</i> <i>Dokumenti 36: Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion si dhe nga verifikimet e bëra në Institucion, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme dhe ato të arritura, reflektojnë praktikave më të mira dhe arritjet e personelit akademik dhe studentëve. Ato gjithashtu ofrojnë analizë të dobësive të identifikuar dhe masat për adresimin e këtyre mangësive, duke përfshirë ristrukturimin e programeve, përmirësimin e standardeve akademike, dhe fuqizimin e infrastrukturës mësimore.</p> <p>KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku bën pjesë edhe njësi ofruese e programit të studimit, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive të konstatuara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 30.6: Format raporti për kontrollin e provimeve</i></p>

	<p><i>Dokumenti 38: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese te programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korrigjimit të provimeve, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve vlerësuese dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese. Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen kontrole nga Përgjegjësi Departamentit/Dekani gjatë orës së mësimit. <i>Megjithatë, nuk ka informacion për testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</i></p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 38: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese te programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>GVJ konstaton se, Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative duke përdorur metoda të tërthorta, në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët, pyetësorët online në UET LMS, fokus grupet, mbledhjet e bordit të punës me të diplomuar (alumni) të cilët synojnë përfshirjen e ish-studentëve në aktivitete dhe shkëmbimin e eksperiencave në UET.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, të fakulteteve dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Institucioni përdor edhe aktivitete të tjera të rëndësishme, të cilat shërbejnë për të vlerësuar dijet e kompetencave që transmeton ky program studimit: Panairi i Përvitshëm i Punës, mbledhjet e personelit akademik, ndihmës akademik, vizita monitoruese nga drejtuesi i departamentit, Dekani, Përgjegjësi i grupit mësimor.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 12.3: Agjenda e takimit BTP</i></p>

dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<p><i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i></p> <p><i>Dokumenti 40: G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_2022.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka implementuar një sistem të strukturuar për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, duke përdorur metoda dhe instrumente të tërthorta si sondazhe dhe intervista me studentë, alumni dhe punëdhënës.</i></p> <p><i>Raportet e vlerësimit dhe masat e marrë për adresimin e mangësive janë të shpërndara dhe miratohen përmes strukturave të vendimmarrjes të institucionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se, IAL ka ngritur strukturat dhe bazën ligjore për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen, KSBC, Departamenti/ Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të KSBC ka personel që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi, nga një anëtar për çdo fakultet, një ekspert të jashtëm si dhe një përfaqësues studentësh, me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Lidhur me sigurimin e cilësisë në Institucion, është edhe ngritja pranë departamentiit e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës.</p> <p><i>Takime në Institucion,</i></p> <p><i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i></p> <p><i>Dokumenti 30.4: Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.</i></p> <p><i>Dokumenti 43.1: Raporti i mobiliteteve - Staf.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe	Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të

<p>detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>përcaktuara qartë në statut dhe funksionojnë mbi baza të qarta ligjore dhe rregullatorë të Institucionit. Këto akte rregullatorë specifikojnë në mënyrë të detajuar mënyrën e krijimit të organeve përkatëse, funksionet kryesore të tyre, proceset e vendimmarrjes dhe ndërveprimin me njësitë e tjera të institucionit. GVJ vëren se detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi sigurojnë ushtrimin e duhur dhe me përgjegjësi të proceseve të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Ndërlidhjen e veprimtarisë midis njësive e garanton KSBC.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 36: Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit përfshihen në mënyrë aktive njësitë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin, si dhe të gjithë anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Ky proces garanton një përfshirje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, duke siguruar një vlerësim të plotë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.</p> <p><i>Takime në Institucion</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_ struktura organizative aktuale _shqip.</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 36: Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka procedura dhe mekanizma të qarta që sigurojnë përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke respektuar integritetin akademik. Kjo është e parashikuar edhe në Kodin e Etikës së UET, ku përshkruhen parimet e etikës akademike dhe publike të detyrueshme për të gjithë, në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit në mjediset universitare.</p>




pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 16: A.II. Kodi i Etikës</i></p>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>GVJ konstaton se në këtë Institucion, UET, pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe mund të japin mendim/ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. Përveç pjesëmarrjes si anëtar në KSBC, ata gjenden edhe në aktivitete të tilla si Panairi i Punës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione arsimore publike dhe private, vendase dhe të huaja, institucione të shoqërisë civile, biznese, partnerë dhe donatorë.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 12.3: Agjenda e takimit BTP</i> <i>Dokumenti 30.10: Format-Matrica e përputhshmërisë së sillabuseve</i> <i>Dokumenti 32: Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale</i> <i>Dokumenti 34: Marrëveshje bashkëpunimi - Lista UET.</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se institucioni ka arritur të krijojë një proces të strukturuar dhe të efektshëm për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në proceset e vlerësimit.</p> <p><i>Pjesëmarrja aktive e stafit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm garanton një proces të drejtpërdrejtë dhe të integruar të vlerësimit, duke respektuar gjithashtu integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë	GVJ konstaton se politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë janë miratuar formalisht, të dokumentuara dhe rishikuar rregullisht

<p>në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>për t'iu përgjigjur ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. Informacioni në nivel program studimi dhe departamenti përcillet te struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën UET LMS.</p> <p><i>Takimet në Institucion;</i> <i>Dokumenti 16: A.II. Kodi i Etikës</i> <i>Dokumenti 30.1: Plani veprimit KSBC</i> <i>Web-i i UET</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i UET saktëson publikimin e veprimtarive përfshirë dhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, në faqen zyrtare të UET. Institucioni respekton lirinë akademike dhe etikën, si dhe garanton përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 16: A.II. Kodi i Etikës</i> <i>Web-i i UET</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ vëren se, rezultatet e vlerësimit të KSBC shoqërohen nga Institucioni një plan masash për të adresuar mangësitë dhe dobësitë e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit. Ky plan synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke përfshirë ndërhyrje të nevojshme në aspektet e mësimdhënies, kurrikulës dhe mbështetjes për studentët. Një mekanizëm i tillë siguron gjithashtu monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve të bëra në programin e studimit. Ky plan masash miratohet nga Senati Akademik dhe zbatohet në vitin pasues akademik.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Institucioni siguron që monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë të kenë ndikim të matshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. GVJ konstaton se Universiteti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet "kontrollit të kryqëzuar" (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në</p>




vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>UET, sipas skemës: drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve e koordinatorit të programit, strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Takime në Institucion;</i> <i>Dokumenti 2: Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.</i> <i>Dokumenti 8: Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> <i>Dokumenti 13: Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave</i> <i>Dokumenti 33: Të dhëna për trajnimet profesionale staf-studentë</i> <i>Dokumenti 36: Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>GVJ, konstaton se, veprimtaritë periodike që organizon Institucioni përfshijnë mbledhjet e Asamblesë së pedagogëve, trajnimet e ndryshme, publikimet në faqen zyrtare të UET si dhe platformën UET LMS, publikime në rrjetet sociale, me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Nuk ka të dhëna për problemet që mund të jenë shfaqur ndër vite në këtë kuadër dhe si janë zgjidhur ato.</i></p> <p><i>Takimet në Institucion:</i> <i>Dokumenti 33: Të dhëna për trajnimet profesionale staf-studentë</i> <i>Faqja zyrtare e UET</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka mekanizma për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, duke angazhuar personelin dhe studentët në veprimtari periodike informimi dhe ndërgjegjësimi.</i></p> <p><i>Institucioni ka treguar angazhim të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës akademike</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	--	------------------------------	-----------------------------	--




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimeve Master i Shkencave në “Imazheri dhe Radioterapi” zhvillohet në kushtet e një kampusi, ku të gjitha ambientet sidomos auditorët e mësimdhënies janë dizajnuar në plotësim të standarteve për mësimin.
2. Personeli akademik i këtij program studimi në UET, ndjehet i vlerësuar dhe i përkushtuar në angazhimin e tij për të arritur rezultate sa më të mira dhe për të merituar vlerësimin e studentëve.
3. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të studimit është bashkëkohore dhe në funksion të programit të studimit në pjesën kryesore të saj.
4. Marrëveshjet dhe bashkëpunimet në funksion të programit të studimit veçanërisht me institucione shëndetësore dhe klinika private janë një element i rëndësishëm në fushën që ofron ky program studimi.
5. Përdorimi i sistemit elektronik UET LMS.

Pika të dobëta:

1. Stafit akademik ka ngarkesë të lartë, i cili angazhohet në lëndët speciale të profesionit duke mbuluar më shumë se 70% të tyre. Nuk ka një shpërndarje pedagogjike dhe shkencore të lëndëve, duke patur parasysh që kemi të bëjmë me nivel Master të Shkencave: Një pedagog mbulon një numër shumë të madh kreditesh në këtë program studimi, që ndikon në performacën akademike (**Standarti I.2. Kriteri 1, Standarti IV.1; Kriteri 2**).
2. Ka nevojë për përmirësim në emërtimin e saktë të programit për të evituar gabimet e mundshme kryesisht nga studentët që vijnë nga jashtë UET (**Standarti II.I Kriteri 7**).
3. Studentët nuk bëjnë praktikë profesionale për pjesën e Radioterapisë të programit “Imazheri dhe Radioterapi” (**Standarti IV.2; Kriteri 3**).

Rekomandime:

1. Institucioni të angazhohet në rritjen e numrit të personelit akademik të specializuar në fushën e radiologjisë studentëve për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të programit të studimit dhe për të rritur cilësinë e mësimdhënies.
2. Institucioni të angazhohet në gjetjen e mekanizmave që do t’u mundësonin studentëve kryerjen e praktikave profesionale edhe për pjesën e Radioterapisë, si një element tejet i rëndësishëm në formimin e tyre profesional.

3. Te rritet buxheti i Institucionit për mbulimin e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare për personelin akademik PAE të programit.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science of the Institution of Higher Education "Imaging and Radiotherapy"

Strengths and affirmations

1. The Study Program Master of Science in "Imaging and Radiotherapy" takes place in the conditions of a campus, where all facilities especially the teaching auditoriums are designed to meet the standards for teaching.
2. The academic staff of this study program at UET, feels valued and committed in its commitment to achieve the best possible results and to deserve the evaluation of students.
3. Infrastructure and logistics in function of the study program is enough contemporary and in function of the study program in its main part.
4. Agreements and collaborations in function of the study program, especially with Health institutions and private clinics are an important element in the field offered by this study program.
5. Use of the UET LMS electronic system.

Weak points

1. There is a high workload of academic staff who are engaged in special subjects of the profession, covering more than 70% of them. There is no pedagogical and scientific distribution of subjects, considering that this is a Master of Science level program: One lecturer covers a very large number of credits in this study program, which affects academic performance (Standard I.2. Criterion 1, Standard IV.1; Criterion 1).
2. There is a need for improvement in the correct naming of the program to avoid possible errors mainly by students coming from outside UET (Standard II.I Criterion 7)
3. Students do not undertake professional practice in the Radiotherapy component of the "Imaging and Radiotherapy" program (Standard IV.2; Criterion 3).

Recommendation

1. The institution should engage in increasing the number of academic staff specialized in the field of radiology to ensure the long-term sustainability of the study program and to increase the quality of teaching.
2. The institution should actively pursue mechanisms that enable students to engage in professional practice in the Radiotherapy component as well, recognizing it as a critical element in their professional training.



3. The institution's budget should be increased to support scientific research and participation in national and international academic activities for the teaching and research staff (PAE) of the program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	